

Në bazë të nenit 144 paragrafi 3 dhe paragrafi 4 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr 02-2315/6 nga data 30.03.2015, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 13-të, të mbajtur më datë 30.03.2015, miratoi:

R R E G U L L O R E
PËR PERCAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR MARRJEN E SINJALIT TË
OPERATORËVE TË RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK
DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME
KËRKESË

I. Dispozitat e përgjithshme

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet lokacioni qendror për mbledhjen e sinjalit nga pikat e largëta të mbledhjes dhe lokacionet për mbledhjen e sinjaleve nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale me kërkesë (në tekstin e mëtejme: pikat e largëta të mbledhjes).

II. Dispozitat e veçanta

Neni 2

Lokacioni qendror për mbledhjen e sinjalit nga pikat e mbledhjes në largësi gjendet në selinë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në Shkup.

Neni 3

Lokacionet e pikave të mbledhjes në largësi, janë të vendosura në këto vendbanime në secilin prej këtyre rajoneve:

- pika e mbledhjes në largësi – Shkup, e vendosur në Shkup e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D1- Crn Vrv/Shkup
- pika e mbledhjes në largësi – Veles, e vendosur në Veles e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D1- Crn Vrv/Veles
- pika e mbledhjes në largësi – Kumanovë, e vendosur në Kumanovë e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D2- Stracin.
- pika e mbledhjes në largësi – Shtip, e vendosur në Shtip e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D3 – Turtel.
- pika e mbledhjes në largësi – Strumicë, e vendosur në Strumicë e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D4 – Boskija.
- pika e mbledhjes në largësi – Manastir, e vendosur në Manastir e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D5 – Pelister.
- pika e mbledhjes në largësi – Ohër, e vendosur në Ohër e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D6 – Mali Vllaj.
- pika e mbledhjes në largësi – Dibër, e vendosur në Dibër e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D7 – Stogovo, dhe
- pika e mbledhjes në largësi – Tetovë, e vendosur në Tetovë e cila shërben si pikë mbledhëse për rajonin D8 – Popova Shapka.

Neni 4

Operatorët që ritransmetojnë shërbime programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, janë të obliguar që deri te pikat mbledhëse në largësi të vendosura në nivel rajonal, në rajonet e theksuara në nenin 3 të kësaj Rregullore, sinjalin e tyre dalës vazhdimisht ta dërgojnë me përmbajtje identike nga ajo që është në dispozicion për parapaguesit e tyre. Në lidhje me obligimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, operatorët që ritransmetojnë shërbime programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë duhet të japin deklaratë të vërtetuar në noter, se sinjali dalës që e dërgojnë deri te pika e mbledhjes në largësi, që gjendet në rajonin në nivel regjional, për shkak të distribucionit të tij të mëtejshëm deri te sistemi për mbikëqyrje programore në lokacionin qendror për mbledhje të sinjalit në selinë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në Shkup, është me përmbajtje identike nga ajo që e dorëzojnë deri te shfrytëzuesit e fundit.

Nëse operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ofron më shumë pako programore deri te shfrytëzuesit e fundit, ai e dërgon sinjalin deri te pika e mbledhjes në largësi, të asaj pakoje programore që i përmban të gjitha shërbime programore që i ritransmeton.

Neni 5

Deri te pika mbledhëse në largësi – Shkup, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë edhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D1/Crn Vrv – Shkup, respektivisht në qytetin e Shkupit dhe komunat: Çuçer Sandevë, Haracinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishtë,

Deri te pika mbledhëse në largësi – Veles, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë edhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D1/Crn Vrv – Veles, respektivisht në komunat: Veles, Çashkë, Sveti Nikollë, Llozovë, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe Kavadar.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Kumanovë, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D2 – Stracin, respektivisht në komunat: Kumanovë, Likovë, Nagoriç i Vjetër, Rankovc, Kriva Pallankë dhe Kratovë.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Shtip, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D3 – Turtel, respektivisht në komunat: Shtip, Probishtip, Koçan, Makedonska Kamenicë, Çeshinovë – Oblleshevë, Karbinci, Zrnovci, Vinicë, Dellçevë, Pehçevë dhe Berovë.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Strumicë, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D4 – Boskija, respektivisht në komunat: Strumicë, Radovish, Konçe, Vasillevë, Bosillevë, Novo Sello, Dojran, Bogdanci, Vallandovë dhe Gjevgjeli.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Manastir, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga rajoni regjional D5 – Pelister, respektivisht në komunat: Manastir, Prilep,

Novaci, Mogilla, Krivogashtani, Dollneni, Krushevë, Demir Hisar, Resnjë, Pllasnicë, Kërçovë dhe Makedonski Brod.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Ohër, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë nga rajoni regjional D6 – Mali Vllaj, respektivisht në komunat: Ohër, Strugë, Vevçani dhe Debarca.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Dibër, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë nga rajoni regjional D7 – Stogovo, respektivisht në komunat: Dibër, Mavrovë Rostushë dhe Qendër Zhupë.

Deri te pika mbledhëse në largësi – Tetovë, sinjalin e tyre duhet ta dërgojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë nga rajoni regjional D8 – Popova Shapka, respektivisht në komunat: Tetovë, Gostivar, Bogovinë, Brvenicë, Vrapçishtë, Zhelinë, Jegunoc dhe Tearcë.

Neni 6

Dërgimi i sinjalit deri te pika mbledhëse në largësi është në llogari të operatoreve të rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë.

III. Dispozitat përfundimtare

Neni 7

Karakteristika teknike të sinjalit të dërguar do të përcaktohen me vendim të Drejtorit.

Hyrja në fuqi

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të zbatohet nga data 31.01.2016.

**Nr. 01-2408/1
30.03.2015
Shkup**

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,**

Llazo PETRUSHEVSKI, d.v.